

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7915  
E shtunë, 26 tetor 2024  
Çmimi 0.50

ORCA: I papranueshëm  
cenimi i dinjitetit të  
studentëve të UP-së | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE



BLINKENI KËRKON ZGJIDHJE  
DIPLOMATIKE PËR KONFLIKTIN  
NË LIBAN | F. 2

MË SHUMË SE 60 % E KOMPANIVE  
EVROPIANE KANË INVESTUAR NË  
ZBUTJEN DHE PËRSHTATJEN NDAJ  
NDIKIMIT TË KLIMËS | F. 6

KOZ-ja BËHET ANËTARE E KOMITETIT  
TË ASOCIACIONIT TË TRUPAVE  
ZGJEDHORE BOTËRORE | F. 7

## EKONOMI



"MBI 200 %" RRRITJE TË TATIMIT  
PËR PRONAT KOMERCIALE NGA VITI  
2025, SI SHIHET KJO NGA OPOZITA  
DHE ASOCIACIONI I KOMUNAVE | F. 8

BQK-ja DHE BERZH-i NËNSHKRUAJNË  
MEMORANDUM MIRËKËPTIMI LIDHUR  
ME QASJEN NË FINANCA PËR GRATË | F. 7

## SPORT



SONTE 'EL CLASICO', REALI E BARÇA  
SYNOJNË TA TREGOJNË FORCËN | F. 10

# KOSOVA DHE SERBIA PËRSËRI S'PAJTOHEN PËR ECJEN PËRPARA DREJT NORMALIZIMIT TË RAPORTEVE

| FAQE 4-5



Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, nuk kanë arritur pajtueshmëri gjatë një takimi të enjten në Bruksel për mënyrën

se si të ecet përpara në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje. Në një takim trepalësh të dialogut nën ndërmjetësimin e

të dërguarit të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, ata thanë se u pajtuan vetëm për disa çështje "më pak të rëndësishme"

INTERVISTË ME ZOGE SHALËN,  
ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE  
TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAJEVE  
NË KOSOVË 1990-1991 (3)

NË BURG U  
PARAPËRGATITËM  
PËR PAJTIMIN  
E GJAJEVE | F. 3



KRYEPROKURORI  
I SHTETIT  
KËRKON NGA  
KRYEPROKURORËT  
RRITJE TË  
EFIKASITETIT  
PËR TRAJTIMIN  
E RASTEVE | F. 7



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky: Rusia do të dërgojë ushtarë koreanoveriorë në betejë brenda ditësh

KIEV, 25 TETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka paralajmëruar të premten se Rusia e ka ndër mend të dërgojë trupa nga Koreja e Veriut në vijën e parë të luftës nga 27 tetori.

Një ditë më herët shërbimi i inteligjencës ushtarake të Ukrainës tha se njësitet e para koreanoveriore, të stërvitura në Rusi, janë dërguar tashmë në rajonin e Kurskit, i cili ndodhet në kufi me Ukrainën.

Forcat ukrainase e nisën një inkursion të madh në gusht në Kursk dhe kanë kapur territor

atje.

Kievi thotë se ky territor po përdoret si zonë e sigurisë kundër sulmeve të Rusisë në Ukrainë.

Zelensky tha të premten se “ushtarët e parë nga Koreja e Veriut pritet të dërgohen nga Rusia në zonat e luftës së shpejti, më 27-28 tetor”. Ai e cilësoi këtë si “përshkallëzim të pastër nga Rusia”. “Bota mund ta shohë qartazi qëllimin e vërtetë të Rusisë, që është vazhdimi i luftës”, tha ai. “Për këtë arsye, një reagim i fuqishëm nga liderët globalë

është thelbësor”, shtoi ai.

Shtetet e Bashkuara thanë më 23 tetor se 3 000 ushtarë koreanoveriorë janë dërguar në Rusi.

I pyetur nëse ka trupa koreanoveriorë në Rusi, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, as nuk e pranoi, as nuk e mohoi.

I pyetur për fotografitë satelitore të trupave gjatë një konference pas një samiti në Kazan të Rusisë, Putini tha se “fotografitë janë gjë serioze, nëse ka fotografi, atëherë ato pasqyrojnë diçka”.



## Blinkeni kërkon zgjidhje diplomatike për konfliktin në Liban

WASHINGTON, 25 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u zotua se do të punojë me “urgjencë” për zgjidhje diplomatike, me qëllim që t’i jepet fund ofensivës së Izraelit në Liban, por tha se fillimisht është thelbësore që të ketë mirëkuptim për çarmatosjen e Hezbollahit.

Hezbollahu është grup militant dhe parti politike që kontrollon shumicën e jugut të Libanit. Shtetet e Bashkuara e kanë shpallur atë organizatë terroriste, ndërkaq Bashkimi Evropian ka vetëm krahun politik të grupit në listën e zezë. Partia e Hezbollahit ka ulëse në Parlamentin libanez.

Gjatë takimit me kryeministrin libanez Najiv Mikati në Londër, Blinkeni po ashtu u zotua për mbrojtjen e civilëve, por nuk kërkoi një armëpushim të menjëhershëm nga Izraeli, i cili varet nga mbështetja diplomatike dhe ushtarake e ShBA-së. “Ne kemi një ndjenjë të urgjencës për arritjen e një zgjidhjeje diplomatike dhe zbatimin e plotë të Rezolutës 1701 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të ketë një siguri të vërtetë përgjatë kufirit mes Izraeli dhe Libanit”, tha Blinkeni për gazetarët, duke shtuar se është i angazhuar “në mënyrë



intensive”.

Rezoluta 1701, e miratuar më 2006, pas një lufte në mes të Izraelit dhe Hamasit, bën thirrje për çarmatosjen e grupeve joshitetërore në Liban, që është një aluzion për Hezbollahun, që financohet nga Irani, grup që ka

ushtrinë e tij. Rezoluta, po ashtu, kërkon tërheqjen e plotë të Izraelit nga shteti.

Blinkeni tha se është thelbësore të ketë “mirëkuptimin e nevojshëm për zbatimin e plotë të Rezolutës 1701”. “Sa më shpejt që të bëhet kjo, aq më

shpejt do të arrijmë të një zgjidhje”, tha Blinken.

Ai bëri thirrje për mbrojtjen e civilëve dhe ushtarëve libanezë, pasi të paktën 11 nga ta janë vrarë që kur Izraeli nisi ofensivën tokësore në Liban muajin e kaluar.

ShBA-ja ka bërë thirrje për forcimin e Forcave të Armatosura të Libanit dhe qeverisë së brishtë qendrore në Bejrut, në mënyrë që të mund të ketë ndryshim të sigurisë dhe Hezbollahu të lihet në hije. Kryeministri libanez Mikati tha se vetëm shteti dhe ushtria libaneze duhet të ketë armë. Ndërkaq, në një takim të ndarë me Blinkenin, ministri i Jashtëm i Jordanisë, Ayman Safadi, i tha kryediplomatit amerikan se qeveria libaneze e ka bërë të qartë se do ta respektojë Rezolutën 1701.

“Agresioni në Liban duhet të ndalet menjëherë. Asgjë nuk mund të justifikohet me vazhdimin e tij”, tha Safadi.

Hezbollahu dhe Izraeli kanë këmbyer zjarr në kufi që kur nisi lufta në Gazë më 7 tetor 2024, pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - sulmoi Izraelin, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Që atëherë, si pasojë e ofensivës izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 42 000 palestinezë.

Ndërkaq, në fillim të tetorit të këtij viti tensionet mes Hezbollahit dhe Izraelit u përshkallëzuan dhe Izraeli njoftoi për nisjen e një operacioni tokësor në jug të Libanit kundër Hezbollahit.

## Grupi kurd merr përgjegjësinë për sulmin ndaj firmës turke të mbrojtjes

Ankara, 25 tetor - Një grup militant kurd e ka marrë përgjegjësinë të premten për një sulm ndaj selisë së një kompanie të rëndësishme të mbrojtjes në Ankara, ku u vranë së paku pesë njerëz.

Në një komunikatë, krahu ushtarak i Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, PKK, tha se sulmi i 23 tetorit ndaj kompanisë së mbrojtjes

dhe hapësirës ajrore të Turqisë, TUSAS, u krye nga dy anëtarë të saj, si përgjigje ndaj “masakrave” të Turqisë dhe veprimeve të tjera të saj në rajonet kurde.

Një grup militant kurd e ka marrë përgjegjësinë të premten për një sulm ndaj selisë së një kompanie të rëndësishme të mbrojtjes në Ankara, ku u vranë së paku

pesë njerëz.

Në një komunikatë, krahu ushtarak i Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, PKK, tha se sulmi i 23 tetorit ndaj kompanisë së mbrojtjes dhe hapësirës ajrore të Turqisë, TUSAS, u krye nga dy anëtarë të saj, si përgjigje ndaj “masakrave” të Turqisë dhe veprimeve të tjera të saj në rajonet kurde.



# Kosova dhe Serbia përsëri s'pajtohen për ecjen përpara drejt normalizimit të raporteve

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petković, nuk kanë arritur pajtueshmëri gjatë një takimi të enjten në Bruksel për mënyrën se si të ecet përpara në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje. Në një takim trepalësh të dialogut nën ndërmjetësimin e të dërguarit të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, ata thanë se u pajtuan vetëm për disa çështje "më pak të rëndësishme".

Duke folur pas takimit kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se në fokus të takimit ishte gjetja e një mënyre për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazë, për të cilën Kosova dhe Serbia u pajtuan në fillim të vitit 2023. "Fatkeqësisht për temën kryesore që jemi mbledhur nuk ka rezultat. Në pikën rreth ecjes përpara në normalizimin e raporteve. Serbia, me gjasë, ende po ngul këmbë në zbatim të pjesshëm, pra sipas idesë, 'ne bëjmë diçka ju bëni diçka'", tha Bislimi.

Kryenegociatori i Serbisë, Petar Petković, tha pas takimit se Beogradi "nuk po ik" nga detyrimet që dalin nga Marrëveshja Bazë, por se Prishtina duhet të jetë e para që do të fillojë, duke nisur me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Thelbi i asaj Marrëveshjeje nga Ohri është, para së gjithash, formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", tha Petar Petković, duke shtuar se ajo është "shtylla" e procesit të dialogut.

Kosova ngul këmbë se kjo marrëveshje duhet të nënshkruhet së pari, edhe pse BE-ja thotë se ajo është detyruese për palët pavarësisht nënshkrimit, dhe e ka akuzuar Serbinë edhe në të kaluarën se dëshiron vetëm zbatimin e pjesshëm të saj. Takimi trepalësh i pasoi takimet dypalëshe që i dërguari i bllokut Miroslav Lajčak mbajti me përfaqësuesit e të dyja vendeve



fillimisht.

Bislimi shtoi se pala serbe ka thënë se kryeministri i Serbisë, Millosh Vuçević, ia ka dërguar një letër Komisionit Evropian, në të cilën thekson se shteti i tij është i përkushtuar t'i zbatojë detyrimet që dalin nga Marrëveshja Bazë. Por, ai theksoi Serbia duhet së pari ta tërheqë letrën e ish-kryeministres Ana Bërnabiq, me të cilën kishte dalë kundër marrëveshjes, për t'u cilësuar si e sinqertë përprojekta e Vuçevićit. Bislimi tha se si kusht, e përsëriti kërkesën e Kosovës që Serbia ta dorëzojë Millan Radoičiqin, të cilin e akuzon si përgjegjës të sulmit vdekjeprurës kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të vendit në shtator 2023.

Në lidhje me themelimin e

Asociacionit, e cila është ndër detyrat kryesore të Kosovës në këtë marrëveshje, Bislimi tha se vendi i tij nuk do t'u ikë detyrimeve nëse nënshkruhet marrëveshja. "Nuk mund të insistohet kur, për këtë punë, së pari duhet të zgjidhet udhëheqja e re e komunave. Mendoj se duhet të plotësohen disa kushte të tjera. Por, e kemi bërë të qartë se në atë moment kur ka pajtim për zbatimin e plotë të Marrëveshjes bazë, Kosova nuk i ikën asnjë prej obligimeve të saja", tha ai.

Në BE, por edhe në NATO, gjithnjë e më shumë po shprehin pakënaqësi lidhur me rrjedhën aktuale të dialogut, duke thënë se procesi nuk po prodhon rezultatet e pritura. Kështu ka konstatuar edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, duke

shprehur shqetësim për këtë.

Disa orë pas takimit, Lajčaku tha se "diskutoam për një numër çështjesh me rëndësi që burojnë nga marrëveshjet e kaluara dhe u pajtuan për hapat e ardhshëm", pa shpjeguar më shumë.

## Për çfarë u pajtuan palët?

Bislimi tha se përjashtuar Marrëveshjen Bazë, në pika të tjera "ka pasur lëvizje". "Për shembull, jemi pajtuar që ta themelojmë një grup punues, i cili do t'i harmonizojë diku 20 certifikata veterinerë, të cilat përdoren për kalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, po ashtu që të kërkohet që trupat e inspektoratit fitosanitar të vendosen në mënyrë të përhershme edhe në pikën

kufitare në Dheun e Bardhë", tha Bislimi.

Kosova e ka akuzuar Serbinë në të kaluarën se i ka penguar mallrat dhe bizneset e Kosovës që kalojnë transit nëpër territorin e Serbisë, pasi Beogradi nuk njihë certifikatën fitosanitare të lëshuar nga Republika e Kosovës.

Certifikatë fitosanitare është dokumenti që e vërteton gjendjen shëndetësore të dërgesës, që lëshohet nga shërbimi fitosanitar për shëndetin e mallrave nga vendi i prejardhjes.

Ndërkohë, ai tha, gjithashtu, se Lajčaku i njoftoi gjatë takimit se Serbia është zotuar se deri në fund të vitit të ardhshëm të lëshohen linjat e interkoneksionit, që ka qenë marrëveshje e energjisë e vitit 2022. "Ne presim me padurim që kjo të ndodhë sepse kjo u shkakton shpenzime të mëdha dhe ta panevojshme importuesve të energjisë", tha ai.

Ky ishte takimi i parë trepalësh pas më shumë se tre muajve, pasi në takimet e kohëve të fundit Bislimi dhe Petković nuk kishin arritur pajtueshmëri për t'u takuar së bashku.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, duke folur një ditë para takimeve në kuadër të dialogut, kishte thënë se mbajtja e një takimi të përbashkët do të varej nga vullneti i palëve. Në takimin e fundit në shtator, Lajčaku nuk arriti t'i bindë Bislimin dhe Petkovićin të mbajnë takim trepalësh, pasi ata kishin mospajtime për temat që do të donin t'i shtjellonin.

Deri më tani ishin zhvilluar takime dypalëshe mes të dërguarit të BE-së për dialogun, Miroslav Lajčak, dhe kryenegociatorit të Kosovës dhe atij të Serbisë, por jo edhe takime trepalëshe.

Herën e fundit kur ishte zhvilluar një takim trepalësh ka qenë takimi i 2 korrikut të këtij viti. Megjithatë, pas takimit palët dolën me qëndrime diametralisht të kundërta rreth asaj që kishte ndodhur në takime.

Palët e kishin akuzuar njëra-tjetrën për "mungesë të gatishmërisë për dialog".

## Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët rritje të efikasitetit në trajtimin e rasteve

PRISHTINË, 25 TETOR - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjiun e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Në këtë takim u diskutua për çështjet penale që ndërlidhen me bashkëpunimin juridik

ndërkombëtar, me ç'rast u.d. Kryeprokurori Kelmendi ka kërkuar që këto raste të trajtohen me prioritet për ta ngritur edhe imazhin e Prokurorit të Shtetit karshi partnerëve ndërkombëtarë.

Një çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe aplikimi i procedurave alternative, si procedura efikase dhe produktive për zgjidhjen e rasteve penale nga ana e prokurorëve të shtetit, aplikimi i të cilave do të ndikojë



në uljen e rasteve penale, zvogëlimin e kostos shtetit dhe palëve në procedurë, si dhe ekonomizimin e kohës.

Edhe për këtë çështje ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ka kërkuar nga kryeprokurorët e prokurorive aplikim e këtyre procedurave në çdo rast kur ka mundësi ligjore, duke i inkurajuar të angazhohen maksimalisht për rritjen e efikasitetit për aplikimin e procedurave alternative.



INTERVISTË ME ZOGE SHALËN, ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAQEVERE NË KOSOVË 1990-1991 (3)

# Në burg u parapërgatitëm për pajtimin e gjaqeve

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 TETOR -

**“Epoka e re”:** Duam, gjithashtu, të na e përshkruani një ditë qëndrimi në burgun e Mitrovicës, duke na sjellë sa më shumë detaje, duke filluar nga kthina dhe qelia e burgut, sjelljet e gardianëve dhe gardianëve.

**Zoge Shala-Malaj:** Si fillim, më duhet t’ju them se kemi qenë të mbyllura në 9 (nëntë) dry, që nga dera hyrëse e burgut e deri te qelia ose pavioni. Zgjimi ka ndodhur në ora 6.00 të mëngjesit me rënien e një burie, dhe në mbrëmje fikja e dritave në ora 21.00. Qëndrimi në burgun e Mitrovicës ka qenë shumë i vështirë. Thuhet se nuk ka pasur burg më të vështirë në tërë Evropën. Nuk e di se si mundet të mbijetojë njeriu aty, ku kushtet nuk kanë qenë as për kafshë e lëre më për njeriun. Në fillim më kanë dërguar në qelinë numër 5. Pas gjashtë muajve, pas transferimit të grupit tonë në burgun e Lipjanit, me zhvendosjen në qelinë numër 6. Ka pasur një rregullore të shtypur e të shpërndarë në të gjitha qelitë e burgut, të cilës nuk ke mundur t’i përmbahesh dhe si rrjedhojë

pasonte ndëshkimi me tortura fizike dhe izolim në qelinë numër 10, e cila ka qenë e famshme për tortura çnjerëzore që janë kryer në të.

Në qeli kemi pasur tetë shtretër, 4 shilte për të qëndruar në to gjatë ditës, një qyp për nevoja fiziologjike, një kantë me ujë dhe një legen. Në tualet kemi shkuar dy herë në ditë; në mëngjes dhe në mbrëmje, ndërsa dalja në ajër të pastër ka qenë dy herë në ditë nga 5 ose 6 minuta. Për të dalë në shëtitore, duhej rreshtuar në rresht për një, duart të lidhura pas shpine dhe të mbahet distanca rreth gjysmë metri, kuptohet, ecja të bëhej me kokën ulur.

Në qeli nuk ke pasur të drejt gjatë ditës të shtrihesh në krevat. Rrinim ulur këmbëkryq. Për çudi më pastaj, prej kësaj të keqeje doli një e mirë- në aksonin për pajtimin e gjaqeve isha e mësuar të rrija këmbëkryq ashtu siç e kërkonte oda.

**“Epoka e re”:** Meqë jemi të përshkrimi, na e përshkruani ju lutem figurën e një udbashi, me emër e mbiemër, duke u bazuar në sjelljen e tij në hetime ndaj jush.

**Zoge Shala-Malaj:** Kam qenë

anëtare e Organizatës Patriotike “IDEALI”. Më kanë arrestuar për herë të parë në shkollë, në gjimnazin 11 Maji (tani Bedri Pejani) në Pejë. Na nxorën nga ora e mësimit bashkë me dy shoqet e mia, që të tria ishim në një klasë, dhe na çuan në zyrën e drejtorit të gjimnazit. Aty na kanë pritë inspektorët e sigurimit - udbashët Mehmet Loci, Demë Muja, Xheladin Beqiri dhe Istref Sadikaj. Këta na dërguan në zyrat e UDB-së në Pejë. Aty kanë filluar të na marrin në pyetje, pyetje nga më të ndryshmet, dhe gjatë pyetjeve që bënin nuk na kursenin as nga torturat, torturat më çnjerëzore, fizike dhe psikike. Në torturimin tim ka qenë pjesëmarrës edhe Mehmet Haskaj. Ai më ka goditur në fytyrë deri sa jam rrëzuar në dysheme, pastaj i është drejtuar Demë Mujës dhe Xheladin Beqirit: “Kjo kështu e meriton, tani ju e keni ne dorë!”. Pastaj këta të dytë vazhdonin torturimin tim. Nganjëherë ndërroheshin. Shkonin te shoqet tjera e vinte Istref Sadiku. Kur ky më qëllonte me shkop të gomës (“Pendrek”) në dorë, dora më binte përmbi tavolinë e kështu lëndohej në të dyja anët, edhe shuplaka edhe shpina, dhe

më nuk funksiononte. Por, pastaj njëri ma mbante dorën e tjetri më godiste. Më dilnin prapa, pra pas shpinës, dhe pa pritur me preknin me një elektroskok, që edhe trurin ma dridhte. Nuk mund të paramendohet se çka kanë bërë krejt këta udbashë, trupshitur e gjakprishur, e më e keqja shqipfolës. Vetëm ata që i kanë përjetuar ato tortura, ata që kanë qenë në dorën e tyre, e dinë mirë se çfarë janë ata, më kuptojnë si duhet, si është që po fole të torturonin, e po nuk fole, prapë të torturonin, të qëllonin fytyrës, duarve, këmbëve e kudo që mundeshin në trup.

Këtu dua të bëjë një sqarim: Ne grupi ynë jemi burgos më 19 dhjetor të vitit 1984. Në aksionin për arrestimin e disa të rinjve të mitur në gjimnazin e Pejës ishte prezent edhe udbashi, i rrezikshmi për të gjitha familjet e kësaj ane, Mehmet Loci. Ai, në një emision të televizionit të Dukagjinit, saktësisht në emisionin e gazetarit Ermal Pandurit “TRADHËTI VËLLEZËRISH, SHQIPTARËT DHE UDB-ja”, ka deklaruar se kur ka rënë grupi i vajzave të Pejës në burg, ka qenë bora e madhe dhe ai ka qenë në spital.

Jo, Mehmet Loci! Në dhjetor të vitit 1984, nuk ka rënë bora e madhe! Bora e madhe ka rënë në gjysmën e janarit të vitit 1985 dhe ka zgjat deri në shkurt, ndërsa në borën e madhe unë jam arrestuar, për të dytën herë, më 1 shkurt të vitit 1985. Gjatë këtij arrestimi kanë qenë prezent Istref Sadiku, Xheladin Beqiri dhe Demë Muja, por ka pasur edhe makina të tjera të policisë. Të vetmet kanë qenë makinat e UDB-së që e kanë qarë borën, kanë hyrë në fshatin tim dhe më kanë arrestuar.

Demë Muja në makinë më ka thënë së kemi pas të të arrestojmë sërish menjëherë pas dy tri dite, por ra bora e nuk mundem të vinim.

**Gënjeshtret e UDB-së dhe drejtori i burgut, Sherafedin Ajeti**

**“Epoka e re”:** Po sjelljet e drejtorit të burgut në Mitrovicë, Sherafedin Ajeti, si ishin?

**Zoge Shala-Malaj:** Drejtori i burgut, i famshmi për të zi, apo famëkeqi Sherafedin Ajeti, ka qenë xhelati i të burgosurve politikë në Mitrovicë. Ky bënte e ç’bënte dhe ditën nuk e mbyllte

pa e torturua së paku një të burgosur politikë. Kështu ka ndodhur edhe me mua dhe shoqet e mia, kur na dërgonin në qelinë numër 10. Aty e dinim që do ta shohim ferrin me sy nga Sherafedin Ajeti si dhe gardianet Fevzija dhe Rozika.

Pas një viti burg në burgun e Mitrovicës u infektova për të dytën herë në trup. Kësaj here kisha shumë temperaturë të lartë dhe dhimbje të forta. Nuk isha në gjendje të ecë dhe as ta lëvizim dorën. Në qelinë numër 6 isha së bashku me një grua tjetër, që ishte dënuar për vjedhjen e arit të Trepçës. Ajo më respektonte dhe duke më parë se në çfarë gjendje isha, pa më pyetur fare trokiti në derë. Vijnë këto dy gardianët dhe pyesin se kush po troket. "Unë", iu thotë ajo, dhe vazhdon tutje: "A nuk po e shihni Zogen që po digjet nga temperatura? Pse nuk po e dërgoni te mjeku?" "Tani vijmë", thonë dhe dalin. Pas një kohe, vërtetë ato vijnë. E hapin derën dhe më drejtohen mua: "Dil, ti!".

Po në vend se te mjeku, më dërgojnë te zyra e drejtorit, Sherafedin Ajeti. Aty, para tij, Rozika më mbanë fort, ndërsa Fevzija më godiste me shkop gome. Më godet në lakun e dorës brenda pak sekondash dora me bëhet e palëvizshme. Nuk kisha fare forcë në dorë, prandaj s'mund e mbaja lartë. E lëshova poshtë. Por, duke e ditur se e kam infeksionin në këmbë, më qëllonjë të dyja pikërisht në të dyja këmbët. Aty unë bie për tokë e pa ndjenja. Pas kalimit të kësaj gjendjeje, nuk e pash veten në qeli me shoqe, por në qelinë famëkeqe, atë me numër 10. Kësaj radhe në të kam qëndruar pesë ditë. Aty kam dëgjuar zëra të burrave duke u torturuar dhe zërin e Sherafedin Ajetit duke iu thënë "nuk keni me dalë të gjallë nga ky vend"! Pastaj vinte të



qelia ku isha unë dhe me thoshte: "Ty ta boj ma zi"! Më binte flakaresh dhe dilte.

**"Epoka e re":** Më lart i përshkruat sjelljet e gardianeve, Fevzijas dhe Rozikës. Keni edhe diçka për të shtuar.

**Zoge Shala-Malaj:** Sjellja e gardianeve në burgun e Mitrovicës ka qenë e tmerrshme. Fevzija, Rozika dhe Minirja, janë gardianet që janë përpjekur në çdo mënyrë ta realizojnë kënaqësinë e tyre, e që ishte torturimi ynë jo vetëm fizik.

Këto dy gardiane, pra Fevzija dhe Rozika, kanë qenë dora e djathtë e drejtorit të burgut. Kur ai ndodhte të mungonte, e zëvendësonin këto të dyja. Kur të torturonin, njëra të mbante e tjetra të godiste.

Më kujtohet një rast, të cilin do ta

ndajë me lexuesit e "Epokës së re": ishte fillimi i pranverës. Në fund të shkallëve të shëtitorës kishte dalë një lule, lule e hershme që çelin në pranverë. U përkula dhe e preka me dorë dhe thashë me vete: po ti këtu çka dole? Më pau gardianja Fevzije dhe zbriti shkallëve, e shkeli aq shumë me këmbë deri sa e teri edhe vendin ku ishte lulja dhe na detyroi të hymë brenda, ashtu siç ishim rresht për një. Isha e fundit në rresht, dhe fjalët e gardianes Fevzijas, apo siç e quanim ne "dhija", ishin: "Ti, lule nuk ke me pa me sy. Ec hynë brenda!". Kur hymë brenda në dhomë, ia ktheva: gardiane edhe ky veprim i yti me lulen e gjorë i shkon për shtati sojit tënd, sepse aty ku shkeli ju, digjet dhe nuk mbinë më bari!

Atë ditë nuk na ka nxjerrë më në

shëtitore. Dhe dihet pastaj, drejt e te zyra e drejtorit, Sherafedin Ajeti. E atje dihej se çka të gjente. Dhe më gjeti. Torturimi.

**"Epoka e re":** Cila është një nga vizitat e prindërve që ju ka mbetur më së shumti në kujtesë?

**Zoge Shala-Malaj:** Vizitat e prindërve si dhe të familjes në përgjithësi kanë qenë çdo dy javë. Secila ka qenë më e vështirë se sa tjetra. Nganjëherë edhe na janë ndaluar nga drejtori i burgut. Ata vinin deri te burgu, pritnin gjatë jashtë, me nga dy e tri orë, në pishë të diellit, në shi apo dhe borë, dhe ktheheshin pa më parë. Më kujtohet një rast, kur sapo më hoqën nga qelia dhe më çuan në pavion, në qelinë numër 5, ndërsa pas tri dite kisha vizitë. Më erdhën prindërit, dhe për çudi ma lejuan vizitën atë

ditë, ani pse nuk kisha dëshirë të dilja, sepse kisha humbur shumë në peshë, ende nuk isha shëruar, sepse siç e tregova edhe më herët, isha e sëmurë dhe torturat e gardianeve ma keqësuan më shumë shëndetin. Por dola. E pash që si nëna, ashtu edhe babai vetëm më shikonin dhe nuk flisnin fare. Për një moment babai kthehet nga gardianja e pranishme, që ishte Minirja, dhe i thotë: "Unë e dua vajzën time në vizitë!". Tek kur fola dhe iu thash që unë jam Zogia, atëherë nëna më thotë: "Oj bijë, oj qika jeme, a je gjë e sëmurë, apo çka ke që koke dobsua? Pse nuk po t'i shof duartë?". E, duart në fakt i kisha të lidhura prapa shpine. Ndërsa e djathta ende nuk më ishte shëruar nga rrahja me shufër gome. Me gjithë forcën që më kishte mbet, shpejt e shpejt i kam vendos në grila. Prindërit kurrë nuk i kam parë të mërzitur në vizitë. Atë ditë i pashë të heshtur. Por, siç kanë ardhur me kokën lartë, ashtu me kokën lartë kanë dalë nga vizita. Në ato pak minuta sa zgjaste vizita, maksimumi pesë minuta, familja apo kushdo që vinte në vizitë, mendohej të na jepte ndonjë informacion. Njëri diçka, tjetri diçka tjetër, dhe ia arrinim të informoheshim, si për familje si për situatën apo burgosjen e ndonjë grupi, kur nuk ishim në dijeni paraprakisht. Prindërit zakonisht flisnin të dytë përmjetherë. Gjithherë babai më thoshte: "Bijë, i ke hy kësaj pune, por ti e ke përkrahjen tonë! Qëndro, se na jemi mirë". Ani pse ishte e ditur se UDB-ja do të bënte trysni në familje, që të mos na përkrahin, ato qëndruan. Familjet tona u njohën mes vete gjatë vizitave që na i bënin në burgje dhe u forcuan edhe më tepër. Në një farë mënyre edhe ato u bashkuan. (Fund)



# Më shumë se 60 % e kompanive evropiane kanë investuar në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndikimit të klimës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Kompanitë në Bashkimin Evropian i përballuan relativisht mirë goditjet shëndetësore dhe tregtare, si dhe çmimet gjatë katër viteve të fundit dhe kanë rritur ambiciet e tyre për transformimin e gjelbër dhe digjital, sipas një ankete të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI). Anketa e Investimeve e BEI-t, 2024, e publikuar në takimet vjetore të Bankës Botërore dhe FMN-së në Uashington, përshkruan një pamje të udhëheqjes së bizneseve të BE-së në tranzicionin e gjelbër dhe përforcimin e zinxhirëve të tyre të furnizimit përballë rreziqeve të shtuara gjeopolitike dhe ndërprerjeve të zinxhirëve të furnizimit.

Shumë firma në Evropë janë të kënaqura me nivelet e tyre të investimeve gjatë tri viteve të fundit dhe janë të përkushtuara për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe për t'i futur teknologjitë digjitale në përdorim, tregon anketa. Ajo mbulon një total prej rreth 12 000 kompanish në të gjitha vendet e BE-së si dhe një mostër krahasimi në Shtetet e Bashkuara.

Ndërsa pjesa e kompanive të BE-së që presin t'i rrisin investimet në vend që t'i ulin është përgjysmuar në një bilanc neto prej 7% në vitin 2024, krahasuar me vitin e kaluar, bizneset në Evropë vazhdojnë t'i tejkalojnë homologet e tyre amerikane dhe të udhëheqin në investime për t'i ulur emetimet që shkaktojnë ndryshime klimatike, ose të përballen me ndikimin e motit të ashpër.

Anketa e fundit e investimeve

tregon se 61% e firmave të BE-së kanë investuar në trajtimin e ndryshimeve klimatike, krahasuar me 56% në vitin 2023 dhe 53% në vitin 2022. Tranzicioni i gjelbër imponon transformim, por sjell edhe mundësi. Më shumë se një e katërta e firmave të BE-së, d.m.th. 27%, e shohin kalimin në një ekonomi neto zero si një mundësi gjatë pesë viteve të ardhshme. "Angazhimi i firmave të BE-së ndaj tranzicionit të gjelbër dhe digjital ilustron potencialin e ekonomisë evropiane", tha presidentja e BEI-t, Nadia Calvino. "Anketa konfirmon se partneriteti publik-privat zë një vend qendror në investimet strategjike për të mbështetur konkurrencën, sigurinë dhe autonominë e BE-së në tregjet globale".

Rreth 90% e firmave të BE-së dhe ShBA-së kanë marrë masa për t'i reduktuar emetimet e gazeve serrë. Strategjitë kryesore të miratuara përfshijnë investimet në reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve dhe efikasitetin e energjisë. Kompanitë e BE-së kanë më shumë gjasa se ato amerikane të kenë miratuar opsione të qëndrueshme transporti, ta kenë zgjedhur prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe të vendosin objektiva për reduktimin e emetimeve. Një në tri kompani të BE-së, d.m.th. 34%, e sheh tranzicionin e gjelbër si një rrezik biznesi krahasuar me 42% në ShBA.

Në BE, 37% e investimeve totale nga bizneset drejtohen drejt asetëve jomateriale si kërkimi, aftësitë dhe njohuritë, duke theksuar një fokus strategjik në novacion dhe në zgjidhjet digjitale. 74% e bizneseve të BE-së



raportuan se përdorin teknologji digjitale, duke shënuar 4% rritje nga viti i kaluar. Ndërkohë, ShBA-ja vazhdon të kryesojë me 81%. Megjithatë, duke parë përpara për tri vitet e ardhshme, shumë kompani evropiane po u japin përparësi investimeve zëvendësuese kundrejt zgjerimit të kapaciteteve, ku vetëm 26% e firmave të BE-së që planifikojnë të zgjerojnë operacionet në tre vitet e ardhshme krahasuar me 47% të firmave amerikane. "Fokusi i kompanive të BE-së në novacion është i mirëpritur dhe duhet mbështetur", shtoi presidentja e BEI-t, Nadia Calvino. "Kjo është arsyeja pse Grupi i BEI-t po punon për një plan të ri veprimi për ta përfortuar integrimin e tregjeve të kapitalit të Evropës dhe në këtë mënyrë kanalizimin e kursimeve private në investime produktive

në Evropë".

Mjedisi i biznesit mbetet një shqetësim për firmat në Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe pasigurinë për të ardhmen si një nga shqetësimet kryesore në të dy rajonet. Investimet e biznesit ende pengohen nga kostot e larta të energjisë, të cilat përbëjnë pengesa të konsiderueshme për 46% të bizneseve të BE-së. Shumica (60%) e eksportuesve të BE-së raportojnë se atyre u duhet të respektojnë standarde dhe rregulla të ndryshme për mbrojtjen e konsumatorit nga një shtet anëtar në tjetrin, duke theksuar se fragmentimi i tregut vazhdon. "Firmat evropiane po bëjnë hapa përpara në adresimin e ndryshimeve klimatike dhe transformimit digjital", tha shefja

e Departamentit të Ekonomisë e BEI-t, Debora Revoltella. "Por nxitja e investimeve të BE-së kërkon një treg të vetëm më pak të fragmentuar të BE-së."

Anketa, gjithashtu, nënvizon rëndësinë e zinxhirëve të fuqishëm të furnizimit. Shqetësimet për ndërprerjet e tregtisë janë zbutur në krahasim me vitin e kaluar, por firmat nuk panë përmirësime për sa iu përket rregulloreve të reja, tarifave apo kufizimeve tregtare. Kompanitë e BE-së janë integruar mirë në tregtinë globale dhe kanë përfituar ndjeshëm prej saj në të kaluarën. Në një botë të re me tensione gjeopolitike në rritje, firmat e BE-së po reagojnë duke rritur qëndrueshmërinë e zinxhirëve të tyre të furnizimit në drejtim të sigurisë ekonomike dhe efikasitetit.



## ORCA: I papranueshëm cenimi i dinjitetit të studentëve të UP-së

**PRISHTINË, 25 TETOR** - ORCA është e neveritur nga instrumentalizimi i studentëve dhe "përfaqësuesve" të tyre nga një pjesë e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, të cilët shtojnë Këshillin e Studentëve të Fakultetit të shkruajnë një letër ku kërkojnë shtimin e stafit akademik në këtë fakultet, një ditë pas letrës sonë publike ku kërkohet të mos privilegohet me shtim të stafit ky fakultet.

ORCA u bënë thirrje studentëve që të mos heqin dorë nga dinjiteti personal pavarësisht joshjeve apo edhe presioneve që mund të kenë.

Letra e Këshillit të Studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, e dërguar një ditë pas reagimit të ORCA-s, është një përpjekje e

turpshme e një pjesë të stafit akademik të atij fakulteti për instrumentalizim të studentëve për të krijuar argumente në favor të vet.

Në këtë situatë, ORCA udhëzon Këshillat e Studentëve të Fakulteteve tjera të veprojnë njëjtë, madje me të drejtë, për ta përmirësuar raportin staf akademik për studentët, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. "Fakulteti Juridik ka vetëm 1 staf akademik për 72 studentë, Fakulteti Ekonomik 1 staf akademik për 64 studentë, ndërkohë ai Mjekësisë, sikur të mos ishte fare në Kosovë por diku në Evropë, 1 staf akademik për 14 studentë. Fakulteti i Mjekësisë ka 25% të stafit akademik në një universitet me

14 fakultete. Kërkesa për shtim të stafit akademik në këtë Fakultet është abuzim pasur parasysh situatën e përgjithshme të numrit të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës. Edhe 7,628 studentë të juridikut dhe ekonomikut janë pjesëtarë të shoqërisë sonë, edhe 7,628 familje të tyre janë taksapagues që mbushin buxhetin e UP-së, edhe ata kanë të drejta të njeriut dhe të drejtën për arsim cilësor si pjesë e atyre të drejtave", thuhet në njoftimin e ORCA-s.

ORCA ka theksuar se do ta kundërshtojë çdo përpjekje për abuzim të parave të taksapaguesve dhe përdorimin e pushtetit nga persona të caktuar për të shtyrë përpara agjendat e veta karrieriste.

## KMDLNj-ja dënon vendosjen e kryqit në varrezat e Bajçinës

**PODUJEVË, 25 TETOR** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas vendosjes së një kryqi të madh në varrezat e fshatit Bajçinë të Podujevës nga persona deri më tani të paidentifikuar. Sipas reagimit, KMDLNj tha se në lidhje me rastin janë njoftuar nga banorët, të cilët e

quajtën provokim dhe përpjekje për shpërfytyrim të varrezave të fshatit ku janë varrosur banorët e këtij fshati që "thuaja njëqind për qind i përkasin besimit islam". "E drejta e ushtrimit të lirë të besimit në Kosovë për të gjithë besimtarët është e garantuar me ligj. Sikur që çdo diskriminim në baza fetare

duhet të sanksionohet me ligjet në fuqi. Vendosja e kryqit në varrezat e fshatit Bajçinë, pa asnjë dyshim ka për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe mosbesimit në baza fetare dhe KMDLNj fuqishëm e dënon këtë shkelje të rëndë të drejtave të njeriut dhe ushtrimit të lirë të besimit. As në kohën e okupimit më të egër të

Kosovës, regjimi i Serbisë nuk ka ndërmarrë një veprim të tillë", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Më tej, KMDLNj-ja tha se është e qartë se "këtë veprim të shëmtuar" nuk e ka bërë një person i vetëm, ku kërkoi hetime të shpejta në mënyrë që, sipas tyre, dhunuesit e të drejtave dhe lirive fetare të



identifikohen, kapen dhe përballen me ligjin.

## BQK-ja dhe BERZh-i nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi lidhur me qasjen në financa për gratë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit lidhur me mbështetjen e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse "WE finance Code" gjatë takimeve vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), që po mbahen në Uashington.

Kjo marrëveshje paraqet përkushtimin dhe zotimin e BQK-së për të mbështetur dhe kontribuar në nismat dhe zhvillimet e nevojshme në sektorin financiar, të cilat

mundësojnë rritjen e qasjes në financa për gratë në biznese të vogla dhe të mesme, në funksion të rritjes së përfshirjes financiare, mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar përmes që është në linjë me Planin Strategjik të BQK-së.

Guvernatori Ismaili gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje me zëvendës-presidentin e BERZh-it, Mark Bowman, ka theksuar se ky është një hap i rëndësishëm dhe se do të kontribuojë në rritjen e përfshirjes financiare në Kosovë duke siguruar një qasje të barabartë në resurset financiare e veçanërisht për gratë ndërmarrëse. "Marrëveshja e mirëkuptimit me BERZh-in paraqet një rast të veçantë duke



ofruar mundësi për të punuar në funksion të gjithëpërfshirjes financiare dhe qasjes në financa në mënyrë të barabartë për të gjithë, duke kontribuar

njëkohësisht në stabilitetin financiar dhe prosperitetin ekonomik në Kosovë", ka potencuar guvernatori Ismaili. Nisma e tillë "WE Finance Code"

u lansua vitin e kaluar nga Banka Botërore në takimet vjetore në Marakesh (Maroko), ku edhe BQK ishte pjesëmarrëse e kësaj nisme, dhe nënshkrimi i saj pikërisht në takimet vjetore, duke iu bashkuar rreth 30 bankave qendrore dhe institucioneve rregullatore deri tani, paraqet një simbolikë të veçantë të përkushtimit sistematik të bazuar në planin strategjik të BQK-së.

Në fund palët u pajtuan të punohet së bashku me aktivitete konkrete që mundësojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, përfshirë edhe organizime të përbashkëta që kontribuojnë në arritjen e qëllimit, në bashkëpunim me sektorin financiar dhe grupet e interesit.

## KQZ-ja bëhet anëtare e Komitetit të Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore



**PRISHTINË, 25 TETOR** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës është zgjedhur anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore (A-WEB) gjatë Asamblesë së Përgjithshme të këtij asociacioni që po mbahet në Bogota të Kolumbisë.

Në njoftimin e KQZ-së thuhet se ky është një sukses i madh ndërkombëtar dhe një hap i rëndësishëm për fuqizimin e rolit të Kosovës në arenën globale të administrimit të zgjedhjeve dhe zhvillimin e standardeve demokratike.

Në këtë Asamble, KQZ-ja u

përfaqësua nga kryesuesi i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi dhe anëtari i KQZ-së, Arianit Elshani. "Prania dhe përkushtimi i përfaqësuesve tanë kanë pasur një rol vendimtar në zgjedhjen e Kosovës në Komitetin Ekzekutiv, duke theksuar angazhimin për organizimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike. Një tjetër arritje e rëndësishme gjatë kësaj Asambleje ishte edhe zgjedhja e KQZ-së së Shqipërisë si anëtare e Komitetit Ekzekutiv të A-WEB", thuhet në njoftim.

KQZ thekson më tutje se kjo përbën një sukses të përbashkët për përpjekjet e të dyja vendeve për

ta promovuar demokracinë dhe për të kontribuar në proceset zgjedhore ndërkombëtare. "Kosova tani ka mundësinë të luajë një rol më të madh në formësimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore në nivel global, duke ndarë përvojat dhe duke përfutur nga bashkëpunimi me organizmat më të rëndësishëm zgjedhore në botë. KQZ e Kosovës është anëtare me të drejta të plota i A-WEB-it dhe tashmë ka ndërtuar partneritet dhe përvojë të mjaftueshme për të qenë pjesë e organit vendimmarrës, në vendosjen e politikave të A-WEB", thuhet në njoftimin e KQZ-së.

## Maqedonci në Turqi: Prodhuesit turq do të jenë ndër adresat shtetërore më të shpeshta për blerje të armatimit

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, gjatë vizitës zyrtare në Turqi, ka zhvilluar disa takime me drejtuesit e Agjencisë së Industrisë të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, si dhe me prodhues të sistemeve ushtarake, me disa prej të cilëve janë prokuruar

sisteme të armatimit dhe pajisje të ndryshme ushtarake.

Në këto takime ai u njoh dhe u informua me inovacionet e fundit në fushën e industrisë së mbrojtjes dhe të mbrojtjes së hapësirës ajrore. Me këtë rast, ai ministri theksoi se prodhuesit e sistemeve të

armatimit nga Turqia kanë qenë dhe do të jenë ndër adresat shtetërore më të shpeshta të blerjeve të armatimit nga Republika e Kosovës, sepse Kosova dhe Turqia janë aleatë dhe partnerë strategjikë për mbrojtje dhe siguri dhe për qëndrueshmëri e paqe.



# 'Mbi 200 %' rritje të tatimit për pronat komerciale nga viti 2025, si shihet nga opozita dhe Asociacioni i Komunave



PRISHTINË, 25 TETOR - Nga viti 2025, pronarët e pronave komerciale do të përballen me fatura të dyfishuara për tatimin në pronë, pasi do të hyjë në fuqi ligji i ri për tatimin në pronat komerciale. Ekspertët paralajmërojnë se kjo rritje enorme do t'i ngarkojë pronarët e bizneseve me kosto të reja, pasi faturat do të bazohen në vlerësimin e pronës që ata kanë.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala, ka thënë për "Telegraf"-in se rritja do të jetë mbi 200 % për biznese. Ai ka pohuar se nga ligji i ri për tatim në pronë preken ekonomitë familjare e bizneset. "Ajo që është karakteristike është se tatimi në pronë është rritur 100 % edhe për ekonomitë familjare, pra kemi ngritje enorme, dhe kemi një ngritje të jashtëzakonshme që ka ndodhur ndonjëherë, mbi 200 % ngritje për biznese. Dy kategoritë që preken nga ky ligj, veçanërisht kategoria e bizneseve, është ndëshkimi që u bëhet. Pasi pronat që shfrytëzohen për biznese do të kenë vështirësi të mëdha pas rritjes së tatimeve", tha ai.

Shala pohoi se "Ekonomia familjare dhe biznese do të jenë të goditura jo meritueshëm". Deputeti theksoi se tashmë kanë shterur të gjitha mundësitë për kundërshtimin e këtij ligji. "Mundësitë ne i kemi shtjerë,

kemi pasur konferenca, komisione e debat me kryeministrin por që, fatkeqësisht, ky ligj është miratuar me shumicën parlamentare dhe tashmë ekziston vetëm një mundësi për ndryshimin/plotësimin e ligjit, por që ajo nuk mund të ndodhë me këtë legjislaturë", tha ai.

Ligji i ri për tatim në pronat komerciale do të jetë vështirë e përballueshme për biznese, kështu vlerëson ish-ministri i Ekonomisë, Haki Shatri (AAK). Shatri për "Telegraf"-in ka thënë se kanë kritikuar në vazhdimësi veprimet e kësaj qeverie. "Sipas asaj që kemi diskutuar edhe më herët, dhe kemi kritikuar këto veprim të qeverisë, që lidhet me tatim, progresin në pronat komerciale, pra në rritje enorme prej vitit 2025, kur hyn në zbatim ky ligj. Bizneset, ndërmarrjet i ngarkon shumë. Sipas analizave që janë bërë nga ekspertë, po ashtu, edhe është mundësia e thjeshtë me u pa, që varësisht prej vlerës së pasurisë komerciale, tatimi në pronë shkon nga 0.10 deri në 0.50 %. Rritet varësisht deri në trefishë", u shpreh ai.

Shatri theksoi se "kjo ngarkesë për ndërmarrjet e mëdha do të jetë e rëndë, pasi e bënë edhe një barrë më të rëndë fiskale. Këto biznese vështirë mund ta përballojnë, nëse e përballojnë e

kufizon për ta zgjeruar biznesin e tyre dhe për të investuar, pra me rrit prodhimtarinë, shërbimet ose thjesht pengon zhvillimin ekonomik".

Ndërsa kryetari i Asociacionit të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka deklaruar se ky ligj për tatim në pronat e paluajtshme është bërë pa asnjë konsultim me komunat. "Ka ndodhur ndryshimi dhe plotësim i Ligjit për Tatim në Pronat e Paluajtshme, është bërë pa asnjë konsultë me komunat e Kosovës, si hisedare kryesore sa i përket grumbullimit të tatimit në pronë, sepse tatimi në pronë mbledhet nga komunat e Kosovës. Dhe komunat në këtë aspekt kanë qenë të përgjaturara nga ky konsultim", ka pohuar Ibrahim për "Telegraf"-in.

Ai, gjithashtu, tha se tashmë edhe qytetarët kanë pranuar fatura më të shtrenjta për pronat rezidenciale. "Ne e dimë që këtë vit qytetarët për prona rezidenciale kanë pranuar fatura që kanë qenë jashtëzakonisht të shtrenjta krahasuar me vitet e kaluara, mirëpo vitin e ardhshëm do të preken drejtpërdrejt pronat komerciale", pohoi ai.

Ibrahim shpjegoi se si do të ndodhë ndryshimi për tatim në pronat komerciale. "Pra, bizneset që janë aktive kanë kaluar në një fazë të rivlerësimit dhe tani faturat e tatimit në pronë, në bazë të ligjit aktual, do të

pranojnë fatura që besojnë do të shkojnë në disa raste deri në 200 % më të shtrenjta sesa kanë pranuar këtë vit".

Ai më tutje shtoi se si "Asociacion i Kosovës me ekspertë që i kemi brenda komunave, kemi bërë një analizë ku janë bërë krahasimet e faktuarve këtë vit me vitin e ardhshëm që do t'u shkojnë pronarëve të pronave komerciale, me rritje enorme në vitet e ardhshme".

Ai shpjegoi edhe disa raste, se si do të bëhet rritja e tatimit në pronat komerciale. "P.sh kemi katër raste nëse vlera e pronës është 7 milionë euro me shkallën tatimore aktuale, pronari i kësaj prone ka paguar tatim 11 mijë e 900 euro, me ligjin aktual, duke u bazuar në shkallën tatimore progresive, në bazë të analizave tona, i njëjti pronari, vitin e ardhshëm, do të paguajë minimalisht 26 mijë euro. Pse po them minimalisht, sepse shkalla tatimore e cila gjendet në këtë ligj, ua lejon komunave të shkojnë nga 0.10 % deri në 1 %. Është rritje mbi 130 %".

Në rastin e dytë ai tha se "nëse një pronë ka vlerën 20 milionë euro, nëse fatura i ka shkuar 34 mijë euro, me ligjin e ri, me shkallën tatimore progresive, i njëjti pronar do të paguajë minimalisht 91 mijë euro. Ngritje mbi 200 %". "Rasti tretë: nëse vlera e pronës është 50 milionë euro, dhe me

shkallën tatimore 0.17 %, vlera e faturës i ka shkuar rreth 85 mijë, me ligjin aktual e njëjta pronë do ta pranojë faturën rreth 200 mijë euro. Një rritje jashtëzakonisht e madhe".

"Rasti i katërt: nëse vlera e pronës është rreth 120 milionë euro, nëse pronari ka paguar rreth 200 mijë euro, vitin e ardhshëm do të paguaj rreth 500 mijë", ka shpjeguar Ibrahim.

Ai, po ashtu, deklaroi se rritja e faturave në këtë nivel do të jetë jashtëzakonisht ndikim në ekonomi. "Tani mund ta merrni me mend, nëse bizneseve u ngrit fatura në këtë nivel, normal se do të ketë impakt edhe në aktivitete të tjera biznesore. Ka mundësi të ngrihet qiraja, mund të shtrenjtojnë produktet, mund të vijë deri te zvogëlimi i fuqisë punëtore. Pra është një zinxhir, të cilin ne si Asociacion konsiderojmë që me këtë ligj do të preken pronat komerciale jashtëzakonisht shumë nga tatimi në pronë", u shpreh ai.

Ibrahim tha se kanë reaguar disa herë dhe se kanë kërkuar nga qeveria që ky ligj të amendamentohet sepse është bërë pa konsulta të komunave. Ai kërkoi të ndërmerren në konsideratë thirrjet e tyre, pasi kjo do të ketë ndikim drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomi. Ligji hyn në fuqi me 01.01.2025.




# Mes vdekjes, frikës dhe absurdit në letërsinë e Dino Buzzatit

Nga: Jola TASELLARI

Absurdi, si një tipar që mbizotëron dukshëm krijimtarinë prozaikë të Buzzatit, ndihet veçanërisht në tregimet e tij. Megjithatë, ishte kritika franceze e kohës, një shtysë e madhe në njohjen e letërsisë së tij, që analizon se përkthimi dhe botimi në frëngjisht i romanit Shkretëtira e tartarëve nxit edhe klasifikimin e këtij të fundit si absurd.

Kritiku francez Maurice Blanchote, mbi përkthimin e romanit në gjuhën franceze shprehet: Një roman që shpejt duhet konsideruar si klasik. Një korrelacion fantastik mes dy fenomeneve, një vepër klasike mbi ekzistencializmin dhe absurdin e jetës, vdekjes dhe kohës midis. Por një vepër që gjallon vetëm përmes përkthimit.[1]

Ndoshta duke lënë kështu të nënkuptuar dallimet në receptimin e romanit mes dy ambienteve letrare të ndryshme, siç ishte ai italian i kohës, dhe vendlindjes së dy rrymave të lartpërmendura, absurdizmit dhe ekzistencializmit, në Francë. Në letërsinë e Buzzatit, dukshëm ndërthuren dikotomitë, bashkë si dhe mbivendosja e temave arketip si jetë-vdekja, rini-pleqëri, motivim-demotivim e të tjera. Në këtë bashkëjetesë të botës reale me atë fantastike dhe konkretes me absurdin, letërsia e Buzzatit eksploron vdekjen, format dhe impaktin e saj. Kjo lidhje mes botës fantastike, po aq sa dhe absurde, reflektohet në dy tematika dikotomike mbizotëruese të letërsisë së tij: absurdi dhe frika / absurdi dhe vdekja, dhe pikëtakimet me njëra-tjetrën (vdekja si dënim dhe vdekja si shpëtim). Nëse do të sprovonim skematizimin e absurdit,



vdekjes dhe frikës në tregimtarinë e Buzzatit, mund ta imagjinonim atë si një trekëndësh, ku në thyerje me traditën pararendëse, në kulmin e saj nuk do të vendosnim vdekjen, por absurdin, dhe në baza, frikën dhe vdekjen, duke parë se si të dyja varen prej fenomenit absurd-izëm.

Tregime si Shembja e Balivernës apo E megjithatë po ju trokasim në derë, i ofrojnë lexuesit një shije të absurdit, por ndërtuar sipas një tjetër tradite letrare. Nga ana tjetër, tregime si I vdekur gabimisht shpërfaqin qartazi absurdin e jetës dhe ndoshta edhe parëndësinë, apo peshën e lehtë të saj. Një ditë të bukur, piktori italian, Lucio Predonzani, u shtang kur në mëngjes lexoi në gazetë shpalljen e vdekjes së vet. I alarmuar, i drejtohet redaksisë, nga ku i rekomandojnë se pavarësisht gabimit të shpalljes, të hiqet si i vdekur, që artit të tij t'i rritet vlera e shitjes. I shokuar se si pa u ndierë fare humbja e tij artificiale as dhe nga e shoqja, dhe me sa shpejtësi u


zëvendësua, me qetësi e ftohtësi të frikshme shkoi në varreza, hapi arkivolin e tij dhe u mbyll aty pa pendesë. Kjo seri vdekjesh e Lucios, e para absurde dhe gabimisht, dhe e dyta e vetëkërkuar, na orientojnë drejt një linje tjetër tematike në letërsinë e Buzzatit, ajo e raportit të absurdit me vdekjen. Këtu, fenomeni i vdekjes, jo vetëm i papërfillshëm e i mosvlerësuar, i trajtuar gati pa respekt, si pasojë e zhgënjimit, mosvlerësimit dhe ndjenjës së pakthyeshme të keqardhjes për veten, na ofrohet dhe si shpëtim, si çlirim nga bota: Kur ende kishte mbetur pak hapësirë nga mbyllja e arkivolit, ngriti veshët të dëgjonte se mos e thërriste kush. Por, jo, askush nuk e thirri. Atëherë e la të binte dhe kapaku i arkivolit iu mbyll plotësisht. Absurdi në tregimet e Buzzatit nuk shfaqet vetëm në rrethanat e ngjarjeve, apo si absurdizëm – absurdizmi klasik francez i shekullit të kaluar. Ai reflektohet në gjuhë dhe përdorimin e mjeteve stilistikore. Në tregimin

Vajza që bie absurdi ndërtohet në qetësinë me të cilën përballen banorët e gradaçelës me një vajzë të re, që gradualisht, duke rënë nga kati i fundit në të parë, rrudhet e plaket. Gjuha e tregimit është e bukur dhe poetike; përshkrimet nuk zënë shumë vend, por sa herë bëhen, shtojnë idenë se Marta nuk po bie vërtet, por sikur po pluskon si një pendëz drejt tokës (Apo mos po pluskon në kohë?). Në tregimin Vajza që bie, Dino Buzzati krijon një rrëfim që kundërshton konvencionalitetin e reales, duke e shtyrë linjën e rrëfimit drejt absurditetit në raport me përvojën njerëzore.

Normalizimi i rrethanave të jashtëzakonshme është një tjetër aspekt që gjallon absurdin në tregimtarinë e Buzzatit, tipar ky që na shfaqet gjithashtu dhe në tregimet Takimi i humbur, Një rast interesant apo dhe i një rasti tjetër klasik, Shtatë katet, ku absurdi i këtij të fundit ndërtohet në rendin antikronologjik të hospitalizimeve, nga kati më i lartë, ku vendosen pacientët me simptoma të lehta, e deri në katin e parë, ku shtrohen ata me simptoma të rënda, me gjithë kalvarin disi tragjik të zbritjes së kateve, gati si një ferr dantesk. Pengesat absurde për të dalë, indiferenca ndaj rrethanave të çuditshme, mungesa e befasisë për irrealen dhe ndjenja e kotësisë shton masën e absurdit në rrëfim. Këtu, Dino Buzzati përdor elemente të absurdit për të krijuar një rrëfim surreal. Me evidentimin e kësaj triologjie tematike; absurd, frikë, vdekje, mund të mbërrijmë në konkluzionin se kemi të bëjmë me një tipar “bashkëjetues”, pra, mundësinë e pranisë së njërit me kushtin e pranisë së tjetrit. Kjo tematikë e vdekjes nuk

ndryshon as në rrjedhën e rrëfimit romanor të Dino Buzzatit. Në romanin Shkretëtira e tartarëve mbizotëron tema e vdekjes, ekzistencializmit, dyshimit, absurdit, gati sikur të ishte shkëputur prej një teksti ekzistencialist francez, si për të provuar dhe një herë atë që kritika franceze thoshte në fillimet e botimit të romanit si fillim në Francë, se ky roman i flet ambientit kulturor francez shumë më tepër se atij italian. Vetëdija, që jehon sipërfaqësisht romanin, duket sikur gjallon vetëm nga dëshira për të jetuar, luftuar përmbi një autoritet mbi unin individual. E ndërtuar përmbi absurdin e pritisjes së pafundme dhe një padije mbi të, romani shpërfaq imtësinë e kalimit të jetës njerëzore nga dëshira tek nevoja, mandej frika e në fund vdekja. Gjuha gati sugjestionuese, na shtyn të mendojmë një fund të errët e të sigurt, sikur personazhet pashmangshmërisht gravitojnë drejt fatit të vet, ndoshta të pavetëdijshëm se nuk ka më kthim pas. Tanimë, me këtë frymë të re, ndryshe nga triada tematike e tregimeve, nuk është më frika ajo që na përplotëson trekëndëshin me absurdin dhe vdekjen, por është koha. Koha, me likuiditetin e saj ka arritur të sheshojë nevojën dhe rëndësinë e individit në jetën e të tjerëve që la pas. Tanimë, jeta ka mbetur një udhëtim linear i panjohur, nga Fortesa deri në destinacionin e fundit, vdekjen. Romani Shkretëtira e tartarëve, nga ana tjetër e kornizon absurdin së pari në anticipimin e pritisjes: Xhiovani Drogo, është vendosur në fortesë duke pritur një pushtim hipotetik prej tartarëve. Megjithatë, pushtimi nuk ndodh kurrë dhe ai i kalon vitet më të mira të jetës së tij duke pritur për një ngjarje që duket gjithnjë e më e pamundur. Absurditeti gjallon në pritisjen dhe kotësinë e saj, pa kurrfarë sulmi në sfond. Në Shkretëtirën e tartarëve, Buzzati i bashkon me mjeshtëri këto tema së bashku, duke eksploruar gjendjen njerëzore, absurditetin e ekzistencës dhe pashmangshmërinë e vdekjes në një botë që shfaqet krejt indiferente ndaj kësaj. Po ashtu si dhe në tregimet e tij, për shkak të emigrimit ideor të autorit nga një formë e prozës në tjetrën, absurdi, frika dhe vdekja ngrihen në nivele të ekzistencializmit, duke sprovuar një zhanër të ri në ambientin letrar italian, dhe që e ngenë autorin në nivele të një shkriktari botëror. /Gazeta “ExLibris”/

## Absurdi



Frika

Vdekja

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## KH Rahoveci, gati për ta eliminuar skuadrën belge

**RAHOVEC, 25 TETOR** - Te kampioni i Kosovës në hendboll, Rahoveci, janë mobilizuar maksimalisht për ndeshjen e dytë të raundit të dytë të Kupës Evropiane. Të

shtunën nga ora 19:00 në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci takohet me skuadrën belge Sezoens Achilles Bocholt. Ndeshjen e parë në Belgjikë, Rahoveci e

humbi me tri gola dallim, 32:29. Ndeshja ishte e barabartë dhe e hapur deri në fund. Kjo jep shpresë se "vreshtarët", të përkrahur nga shumë shikues që pritet të

jenë në palestër, do ta përmbysin rezultatin e ndeshjes së parë. Rahoveci për herë të dytë paraqitet në gara kontinentale, kurse e kërkon suksesin e parë evropian.



## Sonte 'El Clasico', Reali e Barça synojnë ta tregojnë forcën

### "Epoka e re"

**MADRID, 25 TETOR** - Një nga ndeshjet më të mëdha në futboll do të zhvillohet në "Bernabeu" të shtunën në mbrëmje, me Real Madridin që mirëpret Barcelonën për pjesën e lartë të "El Clasico"-s. Barcelona ka shkëlqyer në La Liga këtë sezon, me skuadrën katalanase që aktualisht është në krye të tabelës, ndërsa Real Madridi qëndron i dyti, tri pikë prapa rivalëve të tyre të përjetshëm. Të dy klubet spanjolle kanë arritur fitore në mesjavë në Ligën e Kampionëve kundër skuadrave gjermane, Borussia Dortmund dhe Bayern Munchen. Trajneri i Realit, Carlo Ancelotti, në konferencën për shtyp para ndeshjes së "El Clasico"-s kundër Barcelonës ka shprehur mendimin se kjo përballje nuk ka një favorit të qartë. "Skuadra është

mirë, e motivuar pasi, si gjithmonë, kjo është një lojë e komplikuar dhe argëtuese. Barcelona ka një ide shumë të qartë të lojës. Ka një ekip shumë të guximshëm dhe ne duhet të përgatitemi mirë për lojën", ka thënë Ancelotti. "Ata me të vërtetë po bëjnë shumë mirë, është e vështirë të përmendësh një favorit në një 'El Clasico'. Për fat të mirë, asgjë nuk më mban zgjuar natën. Favorit? Nuk ka, varet nga shumë gjëra, nga mënyra se si i menaxhon ndeshjet. Do të ketë raste kur ne kemi kontroll dhe herë të tjera ata do ta kenë. Dhe menaxhimi i kësaj është shumë i rëndësishëm", ka shtuar ai. "Plani kundër Barçës? Kam diçka në mendje, por duhet ta shihni të shtunën dhe më pas mund të më thoni nëse kam gabuar apo jo", ka përfunduar Ancelotti.

Për "El Clasico" foli edhe trajneri i Barcelonës, Hansi Flick. Ky i fundit



pret një lojë të shkëlqyer dhe me dy ekipet që do t'i përshtaten njëri-tjetrit. "Të jem i sinqertë, nuk mendoj shumë, por ne duam të luajmë dhe mezi presim. 'El Clasico' do të jetë një lojë e shkëlqyer. Kam besim në ekipin tim. Ne kemi qasjen tonë. E patëm kundër Bayernit dhe pamë që duhej të përmirësoheshim. Në çdo ndeshje ju përshtateni. Dhe tani do të përshtatemi me Real

Madridin si në të gjitha ndeshjet. Ka gjithmonë lojtarë rivalë të shpejtë. Gjithashtu, te Real Madridi ka, jam i bindur. Në ekipin tim lojtarët po bëjnë punë të shkëlqyeshme. Skuadra doli në krye kundër Bayernit. Kemi përmirësuar kombinimet, kemi bërë mirë me topin dhe pa top... Jemi të vetëdijshëm se duhet të përmirësohemi dhe duhet të përshtatemi me situata të

ndryshme", ka thënë Flick. "Më pak pushim? Ne nuk mund të bëjmë asgjë për këtë. Real Madridi luajti të martën dhe ne luajtëm të mërkurën. Secili për veten. Lojtarët do t'ia dalin. Ata janë stërvitur shumë mirë. Loja e Real Madridit? Ata do të jenë gati dhe ne po ashtu. Ky është 'El Clasico' me shkronja të mëdha ato nga Gjermania nuk janë të njëjta", ka përfunduar trajneri i Barcelonës. Ndeshja mes dy skuadrave ndër më të mirat në botë fillon nga ora 21:00.

### FORMACIONET E MUNDSHME:

**Real Madrid:** Lunin; Vazquez, Militao, Rudiger, Mendy; Valverde, Tchouameni, Camavinga; Bellingham; Vinicius, Mbappe.

**Barcelona:** Pena; Kounde, Cubarsi, I Martinez, Balde; Casado, Pedri; Yamal, Fermin, Raphinha; Lewandowski.

## Sonte derbi ndërmjet Pejës dhe Bashkimit

**PEJË, 25 TETOR** - Java e shtatë e ProCredit Superligës pritet të sjellë sfida mjaft interesante. Takimi i parë është ndërmjet Borës dhe Trepçës, që zhvillohet në Mitrovicë me marrëveshjen e dy klubeve. Prishtinasit kanë një fitore e pesë humbje, kurse kampionët kanë fitore e dy humbje, në edicionin e ri. Të shtunën do të përballen Peja me Bashkimin. Pejanët kanë dy fitore dhe katër humbje, derisa prizrenasit gjashtë fitore në gjashtë xhirot e para. Verdhëzinjtë synojnë fitoren, pasi kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, derisa portokallezinjtë synojnë fitoren për të vazhduar pa humbje në elitë. Takimi i vetëm i së dielës zhvillohet



ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Proton Cable Prizrenit, por që është mjaft i rëndësishëm. Therandasit kanë tri fitore dhe tri humbje, derisa prizrenasit dy fitore e katër humbje. Java e shtatë do të mbyllet me ndeshjen ndërmjet

Sigal Prishtinës dhe Vëllaznimit që zhvillohet të hënën. Kryeqytetasit e kanë nisur edicionin me katër fitore e dy humbje, ndërsa kuqezinjtë me dy fitore dhe katër humbje.

### PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 7

#### Të shtunën takohen:

17:00 Bora - Trepça  
19:00 Peja - Bashkimi

#### Të dielën takohen:

17:00 Golden Eagle Ylli - Proton Cable Prizreni

#### Të hënën takohen:

19:00 Sigal Prishtina - Vëllaznimi

## Ferizaj mposhti Feronikelin '74

**DRENAS, 25 TETOR** - Ferizaj ka fituar në udhëtim te Feronikeli '74 me rezultat 1-0 në ndeshjen e vlefshme për javën e dhjetë në Albi Mall Superligën e Kosovës. Ekipi i Arsim Abazit ka vazhduar formën e lartë në kampionat duke marrë edhe fitoren e tretë radhazi dhe duke u afruar me ekipet e mesit të tabelës. Pjesa e parë e ndeshjes u karakterizua me lojë të barabartë nga të dyja ekipet por, përkundrazi rasteve, portat mbeten të paprekura dhe ekipet shkuan në pushim me rezultat 0-0. Në pjesën e dytë pati më shumë raste nga të dyja ekipet, por vetëm mysafirët arritën ta gjejnë golin. Goli i vetëm në këtë ndeshje erdhi në minutën



e 78 të ndeshjes me anë të Abdeen Abdull, i cili shënoi për 1-0 dhe ky doli të ishte rezultati përfundimtar. Pas kësaj fitore, Ferizaj e shih veten në kuotën e 13 pikëve në vendin e shtatë, po aq sa ka Suhareka në vendin e gjashtë, ndërsa Feronikeli mbetet i fundit me vetëm dy pikë. Në ndeshjen e ardhshme, "Ujqit" e presin Malishevën, ndërsa "Industrialistët" udhëtojnë te Llapi.

## Drejtuesit e KOK-ut pritën ekipin e aeronautikës pas suksesit në Evropian

Prishtinë, 25 tetor - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Ismet Krasniqi dhe nënpresidenti Milaim Kelmendi, kanë pritur ekipin e aeronautikës, pas suksesit të shënuar në Kampionatin Evropian, disiplina precizion në paragllajdizëm (FAI Class 1), të

mbajtur në Gjirokastrë të Shqipërisë. Kosova fitoi medaljen e argjendtë në ekipore, ndërsa të bronzitën me Migjen Shalën në individuale. Paraqitje të mirë patën edhe garuesit e tjerë, të cilët me pak fat kanë mundur të përfundojnë në zonën e medaljeve.

Presidenti Krasniqi, duke përgëzuar ekipin për suksesin e arritur, theksoi se me medaljet e fituar në një garë të nivelit të tillë, janë duke bërë krenarë vendin tonë. Kryetari i Federatës Aeronautike të Kosovës, Avni Kuçi, foli për sfidat dhe suksesin e arritur në të 12 raundet, duke

thënë se në ekipore në momentet e fundit humbën vendin e parë. Vëllezërit Migjen dhe Fanol Shala u shquan edhe për rekordet e thyera. Pas Evropianit, Fanolit iu konfirmua rekordi evropian dhe botëror, ndërsa Migjenit rekordi evropian.



## Matthaus: Neueri nuk është shtylla e Bayernit

MUNCHEN, 25 TETOR - Disfata 4-1 e Bayern Munchenit ndaj katalanasve të Hansi Flick bëri aq shumë zhurmë sa u përhap në të gjithë Evropën. Jo aq për shkak se Barcelona ishte një kundërshtar e përbalueshëm në letër, por për shkak të mënyrës se si po rrjedhin gjërat për Kompany dhe

lojtarët e tij, me vetëm një fitore në pesë ndeshjet e luajtura midis kampionatit dhe Evropës. Përveç medieve gjermane, megjithatë, edhe Lothar Matthaus, legjenda e Bayernit dhe kombëtares gjermane, ka dashur t'i drejtojë gishtin dikujt për humbjen 4-1, që pësoi "Die Roten" të

mërkurën në mbrëmje. Domethënë, ka shigjetuar portierin dhe simbolin bavarez, Manuel Neuer: "Nuk dua ta lëndoj Manuelin, por për momentin nuk është shtylla e skuadrës, siç ishte në të kaluarën. Neueri nuk është vetvetja tani. Shpresoj që ta gjejë sërish lojën

dhe besimin e tij të vjetër. Në të kaluarën, nga tri goditje në portë, ai priste patjetër një ose dy. Ndaj Barcelonës duhej të kishte evituar një ose dy gola nga katër të pësuar. Goli i dytë i Barcelonës është një shembull i mirë për të treguar se nuk është vetvetja. Manuel hezitoi, më pas vendosi



të dilte jashtë zonës, por nuk mundi të bënte asgjë për ta parandaluar golin".

## Viniciusi e Haalandi janë tashmë më të shtrenjtët e futbollit

MADRID, 25 TETOR - Si në çdo gjë në jetë, çdo fillim e ka një fund. Nuk i shpëtojnë këtij "ligji të pashkruar" as yjet e futbollit. Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo dominuan skenat e këtij sporti për më shumë se dy dekada, por tani duhet t'i hapin rrugën një gjenerate të re, që gjithsesi do ta ketë shumë të vështirë të arrijë sukseset e tyre. Si "Pleshti" ashtu edhe "CR7" pranuan të bëjnë kompromis me këtë, duke u larguar nga futbollit i rëndësishëm, siç është ai evropian, me argjentinasi që zgjodhi Amerikën, ndërsa "luzitani", Arabinë Saudite, por kurba në zbritje e karrierës së tyre konfirmohet edhe nga "Transfermarkt". Sipas specialistëve, Lionel Messi ka kapur pikën më të ulët sa i përket vlerës së tij në merkato që nga viti 2006. Tani që luan tek Inter Miami, kartoni i kampionit të botës vlerësohet 25 milion euro. Akoma më "pikiatë" është zbritja e rivalit



të tij të përjetshëm. Pavarësisht se kontrata me Al-Nassrin është një nga më të pasurat në botë, kartoni i Cristiano Ronaldos në merkato vlerësohet vetëm 15 milion euro. Tashmë vendin e tyre në listën e futbollistëve më të vlerësuar e kanë marrë yjet e rinj. Sipas "Transfermarkt", lista kryesohet

nga Vincius Junior i Real Madridit dhe Erling Haaland i Manchester Cityt, të cilët vlerësohen në 200 milionë euro, ndërsa pas tyre vijjnë Jude Bellingham e Kylian Mbappe të vlerësuar në 180 milionë euro dhe për të plotësuar "top 5" mendon spanjollli Lamine Yamal i vlerësuar në 150 milionë euro.

## Bostoni triumfon jashtë fushe, Denveri turpërohet në shtëpi

Uashington, 25 tetor - Boston Celticsi ka korrur fitoren e dytë sezonale në NBA, duke mundur 122-102 Washingtonin. Ndeshje e dominuar nga miqtë, ku u dalluan Brown me 27 pikë e Tatum me 25 pikë e 11 rebounde. Vendimtar edhe stoli për miqtë, nga ku erdhën 44 pikë. Fitoren e parë arriti Dallasi, që mundi me rezultat 120-109 San Antonion në derbin teksan. Luka Donçiqi me 28 pikë e 10 rebounde ishte më i miri në fushë, mbështetur edhe nga Klay Thompson, që realizoi 22 pikë në debutimin e tij me



Mavericksin. Fitore në sekondat e fundit jashtë fushe arriti ekipi i Minnesotas, që mundi me rezultat 117-115 Sacramenton.

Ndeshje e vendosur nga 65 pikët e dyshes Randle-Edwards. Zhgënjoi Denveri, që në fushën e tij u mund thellë 102-87 nga Oklahoma.

### REZULTATET

Washington - Boston	102-122
Dallas - San Antonio	120-109
Denver - Oklahoma	87-102
Sacramento - Minnesota	115-117

### SHKURT

#### Saipi, pjesë e formacionit të javës në Ligën e Konferencës

Portieri i Kombëtares së Kosovës, Amir Saipi, ka vazhduar me paraqitje të mirë me klubin e tij zviceran, Lugano. Ai ka bërë paraqitje të jashtëzakonshme në Ligën e Konferencës të enjten mbrëmë. Lugano fitoi në udhëtim te Mlada Boloslav me rezultat 1-0 në ndeshjen e raundit të dytë të Ligës së Konferencës. Më meritoni për këtë fitore të zviceranëve ishte portieri i Kosovës, Amir Saipi. Ai arriti t'i bëjë pesë pritje në këtë takim, ndërsa priti edhe një penallti në minutën e 81-të duke pamundësuar barazimin e rezultatit. Pas kësaj paraqitje, Saipi u vlerësua me notë 8.7 dhe është pjesë e formacionit më të mirë të javës nga faqja e specializuar e statistikave Sofascore. Më të vlerësuar se portieri i dardanëve ishin vetëm sulmuesi i Celje, Armand Kucys me notë 9.2 dhe lojtari i Shamrock Rovers, Graham Burke me notë 8.8.

#### Mbappe pritet ta fitojë çështjen ligjore kundër PSG-së

Ylli i Real Madridit, Kylian Mbappe, thuhet se do ta fitojë çështjen ligjore kundër ish-skuadrës së tij, Paris Saint-Germain, rreth një dëmshpërblimi prej 55 milionë eurosh. Sipas gazetës franceze "L'Equipe", Mbappe do të fitojë në mosmarrëveshjen e tij ligjore kundër PSG-së. Komisioni i LFP do të vendosë në favor të Mbappes javën e ardhshme me francezin që do të paguhet 55 milionë euro nga kampioni i Ligës 1. 55 milionë euro janë ato që i detyrohen Mbappes nga PSG si bonuse dhe paga të papaguara gjatë vitit të fundit të kontratës së tij. Pritet që PSG-ja ta apelojë vendimin pasi këmbëngul se nuk duhet t'i paguajë më para Mbappes pasi ai refuzoi ta zgjasë kontratën e tij. PSG-ja më parë apeloj vendimin e mëparshëm dhe tani do të apelojë sërish për herë të dytë.

#### Ish-futbollisti i Marseilles vdes në moshën 35-vjeçare

Ish-futbollisti i Marokut, Abdelaziz Barrada, ka ndërruar jetë në moshën 35-vjeçare, lajm i konfirmuar nga klubet franceze Paris Saint-Germain dhe Marseille, ku ai kishte luajtur gjatë karrierës së tij. "Pusho në paqe, Abdelaziz", shkroi Marseille në platformën X, ndërsa PSG shprehu "trishtimin e madh" për humbjen e tij. Barrada, i lindur në Francë, e nisi karrierën te PSG përpara se të transferohej në Getafe në Spanjë. Pas një periudhe të shkurtër tek Al Jazira në Abu Dhabi, ai u kthye në Francë për të luajtur me Marseillen në vitin 2014, por dy vjet më vonë u rikthye në Gjirin Persik. Ai ka përfaqësuar ekipin kombëtar të Marokut në 28 ndeshje midis viteve 2012 dhe 2015, duke shënua katër gola. Barrada ishte, gjithashtu, pjesë e skuadrës së Marokut në Olimpiadën e Londrës 2012, ku shënoi një gol në barazimin 2-2 kundër Hondurasit.

## Eddie Hearn: Joshua do të ndeshet me Furyn ose Duboisin

Anthony Joshua me siguri do të përballet me ose Daniel Dubois ose Tyson Fury në ndeshjen e tij të ardhshme, thotë promotori i peshave të rënda, Eddie Hearn. Britaniku Joshua, 35 vjeç, pësoi humbjen e katërt në karrierë kur u mposht nga kampioni botërori

IBF-së, Dubois, në stadiumin "Wembley" në shtator. Fury, i cili prej kohësh është përfolur për një superndeshje me Joshuan, do të përballet me kampionin e unifikuar Oleksandr Usyk më 21 dhjetor, pas humbjes së tij ndaj ukrainasit në maj. "Është e

çuditshme ta thuash këtë pas një humbjeje me nokaut, por AJ është në të vërtetë në një pozitë shumë të mirë", ka thënë shefi i Matchroom, Hearn për BBC Sport. "Do të përballemi me Dubois ose Fury në ndeshjen e ardhshme. Kjo është. Nuk kemi

interes për ndonjë ngrohje tjetër." Dubois, 27 vjeç, e rrëzoi Joshuan disa herë para një rekordi të publikut britanik prej 96,000 vetash, përpara se ndeshja të ndërpritej në raundin e pestë. Një ndeshje e dytë ishte përfolur për 22 shkurt në Arabinë

Saudite dhe promotori i kampionit, Frank Warren, ka konfirmuar se Dubois ndoshta do të luftojë në atë datë. Mund të jetë kundër një sfiduesi tjetër, me Hearnin që thotë se Joshua mund të ketë nevojë për më shumë kohë për t'u përgatitur.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:1708/1  
Dt: 25.10.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullore (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Tekstilit	Zëvendësim	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetimi)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Tekstilit

- Msc. i Tekstilit;
- Inxh. i dipl. i Tekstilit drejtimi i Konfeksionit;

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitë të lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 26.10.2024 deri me 24.11.2024.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitë të shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Anari Atelier" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812165191 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "Anari Atelier" L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812165191 ujedno imenovao Likvidatora o sprovdjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Anari Atelier" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812165191 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr.1709 /1  
Dt: 25.10.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullore (Qrk) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës në Ferizaj	Ferizaj	Instruktur/e të profilit Laborantë Mjekësor	Vend i lirë	1	5.8
SHML	Qendra e Kompetencës në Ferizaj	Ferizaj	Instruktur/e të Profilin Ass. Teknik Dentar	Zëvendësim	1	5.8

**I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklarate me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

**II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomate e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomate e nostrifikuara në MASHTI**
- Certifikatat e trajnimeve
- Dëshmi të përvojës së punës (kontratat e punës ose vërtetim)
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

